



**KOLEGJI UBT**

**RREGULLORE**

**PËR AVANCIMIN AKADEMIK TË MËSIMDHËNËSVE NË  
UBT**

**RREGULLORE**  
**PËR AVANCIMIN AKADEMIK TË MËSIMDHËNËS NË UBT**

Në mbështetje të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenin 56 të Statutit të UBT-së, Rektori i UBT-së vendosi miratimin e Rregullores për Avancimin Akademik të Mësimdhënësve në UBT.

**Neni 1**  
**Objekti**

1. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e titullit akademik në UBT, si më poshtë:

- a) Profesor;
- b) Profesor asistent;
- c) Ligjërues, si dhe
- d) Asistent.

2. Të drejtë e marrjes së titullit akademik e kanë të gjithë anëtarët e stafit akademik të rregullt i cili i plotëson kriteret e përcaktuar me këtë Rregullore, duke përfshirë titullin shkencor, referimet dhe botimet shkencore, përvoja akademike, si edhe kontributin e tij për mbështetje në zhvillim institucional, profesional dhe shoqëror.

**Neni 2**  
**Fitimi i Titullit Profesor**

1. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "Profesor", duhet të dëshmojë përmbushjen e kërkesave të mëposhtme:

1.1 Dëshmi e fitimit të gradës së nivelit të Doktoratës (për stafin i cili ka fituar titullin shkencor jashtë Republikës së Kosovës kërkohet nostrifikimi nga MASHT);

1.2 Dëshmi për nivelin e lartë të përvojës shkencore nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikimeve shkencore pas përfundimit të studimeve të doktoratës. Kriteri do të konsiderohet i përmbushur nga kandidati në rast të prezantimit të së paku 7 (shtatë) publikimeve shkencore të publikuara, nga të cilat preferohet që, së paku 3 (tre) prej tyre të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare (me recension ndërkombëtar) me Bord editorial dhe faktor impakti, si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2018, Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension;

1.3 Të ketë së paku 7 (shtatë) vite përvojë pune akademike, prej të cilave 6 (gjashtë) vite pas marrjes së titullit shkencor Doktor, aftësi të dëshmuar për udhëheqje akademike apo angazhim në pozicione drejtuese

ne institucione te arsimit te larte apo struktura arsimore, si dhe të dëshmojë që së paku 3 (tre) vite ka mbajtur titullin profesor asistent, përjashtimisht rasteve në të cilat aplikohet neni 2, paragrafi 2 i kësaj Rregullore;

1.4 Përvojë e dëshmuar afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme, apo eksperiencë të tjera të rëndësishme si anëtarë në hartimin e dokumenteve strategjike, akteve normative të lidhura me fushën e eksperiencës, redaktime shkencore në libra akademike, anëtarë në organe kolegjiale me rëndësi në fushën e arsimit ose fushën përkatëse të kandidatit. Vlerësohet si arritje e larte akademike autorësia apo bashkautorësia ne botimin e librave ose monografive.

1.5 Aftësi të dëshmuar arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme dhe udhëheqjes shkencore të temave ne nivelin e doktoratës ose atë master (së paku tri prej tyre);

1.6 Aftësi të dëshmuar për udhëheqje akademike apo angazhim ne pozicione drejtuese ne institucione te arsimit te larte apo struktura arsimore;

1.7 Aftësi të dëshmuar, qe kandidati të mund mbajë leksione të veçanta, në një të një nga gjuhët e huaja te Bashkimit Evropian, e cila te dëshmohet përmes eksperiencave te mëparshme, nëse ka te tilla, apo certifikimeve të njohjes se një prej gjuhëve të sipërpërmendura;

1.8 Të ketë notën mesatare së paku 8 (tetë) gjatë studimeve në ciklet paraprake.

2. Titulli akademik “Profesor” fitohet për një kohë të pacaktuar për kandidatet të cilit kanë dëshmuar se avancimi është realizuar në përputhje me këtë Rregullore, ndërsa kandidatet të cilët direkt e fitojnë titullin profesor (për arsye specifike të dëshmuara në Komisionin vlerësues), janë të obliguar të ri aplikojnë për titullin e njëjtë, pas periudhës tre vjeçare, duke ofruar dëshmi për avancimin e tyre akademik, hulumtues dhe shkencor. Pas rizgjedhjes e fitohen titullin e përhershëm.

### **Neni 3**

#### **Fitimi i Titullit Profesor Asistent**

1. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor asistent”, duhet të dëshmojë përmbushjen e kërkesave të mëposhtme:

2.1 Dëshmi e fitimit të gradës së nivelit të Doktoratës (për stafin i cili ka fituar titullin shkencor jashtë Republikës së Kosovës kërkohet nostrifikimi nga MASHT);

1.1 Dëshmi për nivelin e lartë të përvojës shkencore nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikimeve shkencore pas përfundimit të studimeve të doktoratës. Kriteri do te konsiderohet i përmbushur nga kandidati ne rast te prezantimit të së paku 5 (pesë) publikimeve shkencore të publikuara, nga të cilat preferohet që, së paku 2 (dy) prej tyre te jene botuar në revista

shkencore ndërkombëtare (me recension ndërkombëtar) me Bord editorial dhe faktor impakti dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2018, Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension;

1.2 Të ketë së paku 3 (tre) vite përvojë pune akademike dhe /ose profesionale në procesin mësimor në një institucion të arsimit të lartë duke përfshirë edhe eksperiencën si asistent. Eksperiencat si praktikant gjatë studimeve të doktoratës ose specializant në institucione të linjës do të shqyrtohen për përmbushjen e këtij kriteri rast pas rasti;

1.3 Përvojë e dëshmuar në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme, apo eksperiencia të tjera të rëndësishme si anëtarë në hartimin e dokumenteve strategjike, akteve normative të lidhura me fushën e eksperiencës, redaktime shkencore në libra akademikë, anëtarë në organe kolegjiale me rëndësi në fushën e arsimit ose fushën përkatëse të kandidatit;

1.4 Aftësi e dëshmuar në arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme dhe udhëheqjes shkencore të temave në nivelin master;

1.5 Të ketë notën mesatare së paku 8 (tetë) gjatë studimeve në ciklet paraprake.

2. Të gjitha emërimet për tituj “Profesor asistent” bëhen për një periudhë kohore, 3 (tre) vite.

#### **Neni 4**

##### **Fitimi i Titullit Ligjërues**

1. Kandidati i cili aplikon për titullin “Ligjërues”, duhet të dëshmojë përmbushjen e kërkesave të mëposhtme:

1.1 Dëshmi e fitimit të diplomës së nivelit Master ose ekuivalent me të;

1.2 Të dëshmojë kompetencë akademike e përvojë shkencore që dëshmohet nëpërmjet së paku 1 (një) punimi kryesor të publikuara në revista shkencore ose konferenca ndërkombëtare në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2018, Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension;

1.3 Përvojë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme apo eksperiencia të tjera të rëndësishme;

1.4 Të ketë notën mesatare së paku 8 (tetë) gjatë studimeve në ciklet paraprake ose të ofrojë dëshmi të shkathtësive dhe përvojës së veçantë profesionale nga industria.

2. Të gjitha emërimet për titullin “Ligjërues” bëhen për një periudhë kohore, 1 (një) vit dhe me të drejtën e aplikimit edhe për dy vite vijuese për të njëjtin titull.

## **Neni 5**

### **Fitimi i Titullit Asistent**

1. Kandidati i cili aplikon për titullin “Asistent”, duhet të dëshmojë përmbushjen e kërkesave të mëposhtme:
  - 1.1 Dëshmi të fitimit të diplomës së nivelit “Master” dhe përkatësisht për Fakultetin e Mjekësisë të ketë të përfunduar Fakultetin e Mjekësisë (në rastin e lëndëve klinike të ketë të përfunduar specializimin apo të jetë të paktën në vitin e tretë të specializimit në rastin e rizgjedhjes);
  - 1.2 Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë;
  - 1.3 Konsiderohet përparësi regjistrimi në studimet e doktoratës në një universitet me rastin e rizgjedhjes;
  - 1.4 Të ketë notën mesatare së paku 8 (tetë) gjatë studimeve në ciklet paraprake ose të ofrojë dëshmi të shkathtësive dhe përvojës së veçantë profesionale nga industria.
  - 1.5 Të dëshmojë përvojë të lartë profesionale për fushën;
2. Të gjitha emërimet për titullin “Asistent” bëhen për një periudhë kohore, 3 (tre) vite.

## **Neni 6**

### **Emërimi dhe përbërja e Komisionit Vlerësues për Avancimin Akademik të Mësimdhënësve të UBT**

1. Komisioni Vlerësues për Avancimin Akademik të Mësimdhënësve të UBT emërohet me vendim të Rektorit, pas rekomandimit të përbërjes së komisionit nga Këshilli Akademik i UBT-së.
  - 1.1 Anëtarët e Komisionit përcaktohen tre nga fusha përkatëse ose e përafërt studimore dhe njëkohësisht të kenë gradë më të lartë akademike. Anëtar të komisionit mund të përcaktohet edhe stafi bashkëpunues i jashtëm;
  - 1.2 Zyrtari i përcaktuar nga Burimet Njerëzore janë anëtar të përhershëm të Komisionit pa të drejtë vote.
  - 1.3 Rektori ruan të drejtën për zëvendësimin e përkohshëm ose të përhershëm të anëtareve të Komisionit.
2. Dekani ose drejtuesi njofton kandidatet brenda 48 (katër dhjetë e tetë) orëve nga hyrja në fuqi e vendimit për përbërjen e komisionit.

## **Neni 7**

### **Mandati i komisionit**

1. Mandati i Komisioni Vlerësues për Avancimin Akademik të Mësimdhënësve të UBT zgjatë deri në shfuqizimin e vendimit për përbërjen e komisionit nga ana e Rektorit.

## **Neni 8** **Procedura**

1. Jo më vonë se 8 ditë nga dita e konstituimit të Komisionit, kryhet shpalljet konkursit.
2. Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumentacionit është 8 (tetë) ditë nga dita e shpalljes.
  - 2.1 Dokumentacioni që i bashkëngjiten aplikacionit për kandidim për titull akademik mbeten në UBT.
  - 2.2 Dokumentacioni i pakompletuar dhe ose i dorëzuar pas afatit nuk merret në shqyrtim
- 2.2 Dokumentacioni depozitohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të selisë së UBT-së. Të dhënat e kandidatit njëkohësisht duhet të jenë të plotësuara në sistemin e UBT-së RIMS (Baza e të Dhënave të Stafit dhe Publikimeve-Kontributit të tyre).
3. Shqyrtimi i aplikacionit realizohet nga Komisioni së paku në periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditore.
4. Të gjithë anëtarët e stafit janë të obliguar të aplikojnë për titull akademik dhe i nënshtrohen vlerësimit nga komisioni.

## **Neni 9** **Njohja e titujve të fituar më parë**

1. Institucioni realizon ekuivalentimin e titujve të kandidateve të fituara më herët në institucionet e tjera në përputhje me kriteret, procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Kandidati i aplikon për ekuivalentimin e titullit akademik, sipas kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.

## **Neni 10** **Vendimi i Komisionit Vlerësues për Avancimin Akademik të Mësimdhënësve të UBT**

1. Komisioni vendimet i merr me shumicën absolute të votave të anëtarëve të komisionit;
2. Çdo kandidati i lëshohet certifikata e fitimit të titullit përkatës, e cila shoqërohet me ceremoninë e certifikimeve të avancimit akademik të personelit akademik të UBT

## **Neni 11** **E drejta e ankesës**

1. Çdo kandidat gëzon të drejtë të ankimojë vendimin e marr rreth kërkesës së tij për një titull akademik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e shpalljes së vendimit;
2. Vendimi i Komisionit vlerësues për avancim të personelit akademik të UBT, shqyrtohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas mbylljes së afatit të ankimit në komisionin e ankesave;

3. Komisioni i ankesave ka këtë përbërje:

1. Një anëtar i Këshillit Akademik;
2. 1 (një) anëtar të Këshillit të Fakultetit;
3. Një anëtar, udhëheqës i fakultetit që nuk ka qenë pjesë paraprake e vlerësimit, si dhe
4. Sekretari pa të drejtë vote.

Komisioni vendimin në lidhje me ankesën e procedon në Këshillin Akademik, dhe ky i fundit i rekomandon Rektorit miratimin.

3. Vendimi i Rektorit do të konsiderohet vendimi përfundimtar.

**Rektori i UBT-së**

Prof. Dr. Sc. Edmond Hajrizi

---

Miratuar me, 14/05/2018